



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 22 Prill 2023

Nr: 396

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMEVE NR. 208 ID, 209 ID, 211 ID, 323 ID, TË
KOALICIONIT PËR REFORMA, INTEGRIM DHE INSTITUCIONE TË KONSOLIDUARA NDAJ
KRYETARËVE TË DISA BASHKIVE, PËR SHKELJE ADMINISTRATIVE, NË ZGJEDHJET PËR
ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 22 Prill 2023, sot unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjet administrative me:

KËRKUES: Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)

NDAJ: Zj. Rajmonda Balilaj, kryetar bashkie Patos;
Z. Rahim Spahiu, kryetar bashkie Dibër;
Zj. Majlinda Bufi, kryetar bashkia Roskovec.

OBJEKTI: Përdorim i burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore

BAZA LIGJORE: Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenet 91, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar vendimi nr. 9 datë 24.12.2020, “të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

K O N S T A T O J :

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka marrë denoncime nga Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK) për organizimin e 4 (katër) veprimtarive publike, nga 3 (tre)

Data: 22 Prill 2023

Nr: 396
Ora: 00:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit ndaj kryetarëve të disa bashkive, për shkelje administrative”

institucione publike, për të cilat pretendohet se janë përdorur fonde publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore nga ana e bashkisë Roskovec, Dibër dhe Patos. Pala kërkuese kërkon hetimin e rasteve të mësipërme për shkeljet e mundëshme të dispozitave të Kodit Zgjedhor.

Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcaktojnë kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, pasi shqyrtova paraprakisht çështjet, vlerësoj se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ për secilën prej tyre.

Meqenëse në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve janë paraqitur 4 (katër) indicie për 3 (tre) subjekte të ndryshme dhe meqenëse objekti i shqyrtimit bazohet në të njëjtat fakte dhe bazë ligjore, në mbështetje të nenit 65, shkronja “ç” të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, u vendos shqyrtimi së bashku i këtyre indicieve.

Në vijim të procedurës administrative, filloi hetimi administrativ, duke kërkuar informacion në lidhje me pretendimet e denoncuesve. Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka kërkuar nga institucionet publike nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, informacion sqarues në lidhje me shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljeve të pretenduara si dhe burimin e fondeve publike të vëna në dispozicion.

Kërkuesi i këtij vendimi ka paraqitur pretendime si më poshtë vijon:

- 1- **Bashkia Patos**, ka kryer 2 (dy) veprimtari publike të regjistruara me nr. 208 dhe 209 ID, për të cilat pretendohet si vijon:
 - **Denoncimin nr. 208 ID**, ku pretendohet se: *“Ditën e shtunë, në datë 11 mars 2023, bashkia Patos ka postuar në faqen e vet në Facebook: “Mirëmëngjes dhe fundjavë të këndshme me rubrikën #fermART i japim zë angazhimit në Bujqësi. Kryebashkiakja Balilaj së bashku me Drejtuesin Politik të Qarkut z. Taulant Balla dhe deputeten e zonës zj. Antoneta Dhima vizituan nga afër serën e fermerit Jurgen Belulaj në Zharrëz për t’u njohur me ecurinë e veprimtarisë së tij, sfidat që ka hasur dhe kërkesat specifike që mund të ketë. Në serën e tij Jurgeni ka kultivuar specat dhe domate. Shumica e prodhimit të Jurgenit shitet pranë pikave të grumbullimit, ku produkti lëviz me destinacion në tregun vendas dhe të huaj. Përkushtimi dhe pasioni i tij në aktivitetin e serës, ka bërë që vit pas viti prodhimi dhe cilësia të rritet. Bujqësia dhe fermerët janë në fokus të Bashkisë Patos, për këtë arsye promovojmë punën e palodhur dhe produktivitetin e këtij sektori. #fermART #ZhvillimRural #IjapimZëAngazhimitNëBujqësi#BashkiaPatos”. Një postim lidhur me këtë aktivitet ka bërë edhe Drejtuesi Politik i Qarkut Fier, Deputeti, z. Taulant Balla: “Patos Në serat me perimetë fermerëve Jurgen Belulaj dhe Roland Xhepa në #Zharrës. Falë edhe skemës së mbështetjes nga AZHBR Rolandi ka përfutur mbështetje në implementimin e serës*

diellore, ku brenda 3 viteve vazhdon kultivimin e kulturave bujqësore. #TëBashkuarJoTëNdarë #ShqipëriaEArthemjaJonë #SkaKohëPërPushim”.

Provat link:

1- <https://www.facebook.com/photo?fbid=571165638376106&set=pcb.571165918376078>

2- https://m.facebook.com/b.taulant/videos/166477639578879?_rdr

- **Denoncimi nr. 209 ID** ku pretendohet se: *“Në datën 15 mars 2023, bashkia Patos ka postuar në faqen e vet në Facebook: I japim zë angazhimit në bujqësi. Vazhdojmë takimet me fermerët tanë për t’u njohur me ecurinë e veprimtarisë së tyre, sfidat që kanë hasur dhe kërkesat specifike që ata mund të kenë. Ndodhemi në serën e Vasil Cupës, i cili ka kultivuar domate. Shumica e prodhimit të Vasilit shitet pranë pikave të grumbullimit. Iniciativa për të furnizuar tregun e brendshëm dhe përkushtimi i punës së tij në sera forcon imazhin e fermerit në bujqësi si dhe përcjell frymë pozitive të angazhimit në sera.*

#fermART #ZhvillimRural #IjapimZëAngazhimitNëBujqësi #BashkiaPatos”

Zhvillimi i këtij takimi është raportuar në ndërfaqen e KQZ nga bashkia Patos. Në njoftim nuk lajmërohet prezenca e drejtuesit politik të qarkut Fier z. Taulant Balla dhe deputetes znj. Antoneta Dhima”.

Nëpërmjet e-mail të datës 14.04.2023 me lëndë “Kërkesë për informacion” i është kërkuar bashkisë Patos, informacion sqarues në lidhje me denoncimin regjistruar me **nr. 208 dhe 209 ID**, dhe nëpërmjet e-mail të datës 19.04.2023, jemi informuar se: *“Ky aktivitet është raportuar nga personi përgjegjës më datë 01.03.2023 dhe është realizuar më datë 06.03.2023, pra 5 ditë përpara se të realizohej dhe janë raportuar si pjesmarrës Kryetare e Bashkisë, Administratoria e Njësisë Administrative, Fermerë dhe blegtorë të ndryshëm si dhe Deputetë të Kuvendit sipas dëshirës. Bashkia Patos nuk bën raportime me emra të deputetëve pasi nuk e di se kush mund të vijë por është në vlerësimin e deputetëve, që nëse e shohin të arsyeshme vijnë në këto takime. Në këtë takim nuk është bërë asnjë deklaratë politike, që ka të bëjë me zgjedhjet e datës 14 maj 2023. Aktiviteti është realizuar në datën 6 mars 2023 dhe është publikuar më datë 11 mars dhe në datën 15 mars, në asnjë ligj apo udhëzim të Republikës së Shqipërisë nuk përcaktohet se aktivitetet duhet të publikohen në ditën kur ato kryhen. Përsa i përket pretendimit se këto aktivitete bien në kundërshtim me nenin 91, të Kodit Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, ju sqarojmë se pas raportimit të këtij aktiviteti nga ana e personit përgjegjës të Bashkisë Patos më datë 1 mars 2023, nga ana e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve nuk është marrë vendim për ndalimin e këtij aktiviteti, në këto kushte Bashkia e ka organizuar sic ishte planifikuar”.*

Pas verifikimit të të dhënave, provave dhe fakteve, vlerësoj se aktivitetet janë raportuar konform parashikimeve të nenit 92, të Kodit Zgjedhor. Gjithashtu, aktivitetet e kryera nuk përbëjnë veprimtari të ndaluara në kuptim të nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, pasi kryetari i bashkisë Patos, ka qenë në kryerjen e detyrave të tij funksionale.

Nga verifikimi i rrethanave dhe fakteve dhe nga këqyrja e materialeve, nuk provohet që në këtë aktivitet janë mbajtur deklarime apo thirrje elektorale.

U provua nga fotot në rrjetin social të bashkisë Patos, se prezent ka qënë Kryetari i bashkisë Patos, zj. Antoneta Dhima, deputet i Kuvendit të Shqipërisë, dhe z. Taulant Balla, deputet i Kuvendit të Shqipërisë. Nga sa është postuar në rrjetin social “Facebook”, konstatohet se nuk ka përmbajtje elementësh elektorale, si postera, logo, materiale propagandistike dhe çdo element tjetër, që mbart mesazhe elektorale.

Denoncuesi pretendon se në këtë aktivitet ka pasur pjesëmarrje të deputetëve. Pjesëmarrja e deputetëve në këto aktivitete nuk është e ndaluar. Referuar Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 8550, datë 18.11.199, “Statusi i Deputetit”, deputeti gëzon një status të veçantë në marrëdhëniet juridike që ka me gjithë organet qendrore dhe vendore në vend. **Pjesëmarrja e tij në aktivitetet e organizuara nga kryetari i bashkisë nuk e kthen aktivitetin domosdoshmërisht në një takim elektorale.** Si pjesë e detyrave funksionale të tij, deputeti ka të drejtë të kërkojë shpjegime për çdo çështje që ka të bëjë me përmbushjen e detyrave të kryetarit të bashkisë.

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezulton se objekti për denoncimet e regjistruara me **nr. 208 dhe nr. 209 për bashkinë Patos**, rase hetimi pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nuk përbëjnë shkelje të neneve 91 dhe 92, të Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.

2- Bashkia Dibër ka kryer 1 (një) veprimtari publike **të regjistruar me nr. 211 ID**, për të cilën pretendohet se:

- Denoncimi regjistruar me **nr. 211 ID**, ku pretendohet se: *“Në datën 10 mars 2023, Bashkia Dibër ka postuar në faqen e vet në Facebook: “Në #Muhurr me deputetin Lavdrim Krashi inspektuam fazën përfundimtare të punimeve për ndërtimin nga e para të Urës së Çikut, pas dëmtimit të asaj ekzistuese. Falë bashkëpunimit të shpejtë midis Bashkisë Dibër dhe Forcave të Armatosura të Ministrisë së Mbrojtjes, ura e re do të jetë lehtësim i madh për lëvizjen e banorëve të Selishtës dhe Muhurrit”. Një postim lidhur me këtë aktivitet ka bërë edhe Deputeti i Qarkut Dibër, z. Lavdrim Krrashi: “Me kryetarin e palodhur, Rahim Spahiu, pamë nga afër vijimin e punimeve për ndërtimin e Urës së Çikut mbi lumin Murrë, në Muhurr që lidh gjithë trevën me Katër Grykët e deri në Mat, shumë shpejt shumë më e bukur e më e fortë se e vjetra. Shembull fantastik i bashkëpunimit të Bashkisë me Forcat e Armatosura për realizimin e këtij projekti. Mirënjohje pafund për Forcat e Armatosura, që përveç misionit të tyre në mbrojtje të integritetit të vendit, japin kontributin e tyre në ndihmë të komunitetit. #BashkëPërDibrën” Zhvillimi*

i këtij takimi është raportuar në ndërfaqen e KQZ nga Bashkia Dibër. Në njoftim nuk lajmërohet prezenca e Deputetit z. Lavdrim Krrashi".

Nëpërmjet e-mail të datës 14.04.2023, me lëndë "Kërkesë për informacion" i është kërkuar bashkisë Dibër, informacion sqarues në lidhje me denoncimin regjistruar me **nr. 211 ID** dhe nëpërmjet e-mail të datës 19.04.2023, jemi informuar se: "Aktiviteti i organizuar nga bashkia Dibër, të cilit i referohet kërkesa juaj, lidhet me datën 10 Mars 2023, ku kryetari i bashkisë ka inspektuar punimet në Urën e Cikut në Muhur, ku prezenca e deputetit z. Lavdrim Krrashi ka qenë rastesore dhe ne nuk kemi patur dijeni për pjesëmarrjen e tij në takim përpara se të bëhej raportimi në ndërfaqen e KQZ".

Pas verifikimit të të dhënave, provave dhe fakteve, vlerësoj se aktiviteti është raportuar konform parashikimeve të nenit 92, të Kodit Zgjedhor. Gjithashtu, aktiviteti i kryer nuk përbën veprimtari të ndaluar në kuptim të nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, pasi kryetari i bashkisë Dibër, ka qenë në kryerjen e detyrave të tij funksionale.

Nga verifikimi i rrethanave dhe fakteve dhe nga këqyrja e materialeve, nuk provohet që në këtë aktivitet janë mbajtur deklarime apo thirrje elektorale.

U provua nga fotot në rrjetin social të bashkisë "Dibër", se prezent ka qenë Kryetari i bashkisë Dibër dhe Deputeti z. Lavdrim Krrashi. Nga sa është postuar në rrjetin social "Facebook", konstatohet se nuk ka përmbajtje elementësh elektorale, si postera, logo, materiale propagandistike dhe çdo element tjetër, që mbart mesazhe elektorale.

Denoncuesi pretendon se në këtë aktivitet ka pasur pjesëmarrje të deputetëve. Pjesëmarrja e deputetëve në këto aktivitete nuk është e ndaluar. Referuar Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 8550, datë 18.11.199, "Statusi i Deputetit", deputeti gëzon një status të veçantë në marrëdhëniet juridike që ka me gjithë organet qendrore dhe vendore në vend. **Pjesëmarrja e tij në aktivitetet e organizuara nga kryetari i bashkisë nuk e kthen aktivitetin domosdoshmërisht në një takim elektorale.** Si pjesë e detyrave funksionale të tij, deputeti ka të drejtë të kërkojë shpjegime për çdo çështje që ka të bëjë me përmbushjen e detyrave të kryetarit të bashkisë.

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezulton se objekti për denoncimin e regjistruar me **nr. 211 për bashkinë Roskovec**, rase hetimi pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nuk përbën shkelje të neneve 91 dhe 92, të Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.

3- Bashkia Roskovec, ka kryer një veprimtari publike e regjistruar me **nr. 323 ID**, për të cilën pretendohet se:

- **Denoncimi** regjistruar nr. **323 ID** "Në datën 8 prill 2023, kryetarja e bashkisë Roskovec ka postuar në faqen e vet në Facebook: "Roskovec me kryetaren e Bashkisë Majlinda Bufi pamë nga afër punën që vijon me ritme të shpejta për rikonstruksionin e rrugës "Shyqo Refati" në #Strum. Ndërhyrja në këtë segment parashikon shtrimin me asfalt, rehabilitimin e trotuareve, gjelbërimin dhe vendosjen e sistemit të ri të ndriçimit. Premtim i mbajtur #TëBashkuarJoTëNdarë #ShqipëriaEardhmjaJonë #SkaKohëPërPushim" Një postim lidhur me këtë aktivitet ka bërë edhe Drejtuesi Politik i Qarkut Fier z. Taulant Balla. Zhvillimi i këtij takimi është raportuar në ndërfaqen e KQZ nga Bashkia Roskovec. Në njoftimin e bërë nuk deklarohet paraprakisht nga Bashkia se pjesëmarrës do të ishte edhe z. Taulant Balla".

Nëpërmjet e-mail të datës 17.04.2023 me lëndë "Kërkesë për informacion" i është kërkuar bashkisë Roskovec, informacion sqarues në lidhje me denoncimin regjistruar nr. **323 ID** dhe nëpërmjet e-mail të datës 19.04.2023, jemi informuar se: "Në kuadër të programit të punës së kryetares së bashkisë, është përfshirë inspektimi i punimeve në objektin "Rikonstruksioni i rrugës Shyqo Refati, Strum". Ky aktivitet është raportuar në ndërfaqen e aktiviteteve në KQZ në datën 31.03.2023, ku citohet se ky aktivitet është i hapur për publikun. Për më tepër, duke mos pasur konfirmim të pjesëmarrësve si edhe duke qenë një aktivitet i hapur, edhe pjesëmarrja ka qenë me përfaqësuese të bashkisë Roskovec dhe të tjerë (të tjerë pasi nuk kishim të konfirmuar pjesëmarrjen, psh punonjës të firmës zbatuese, apo deputetit z. Taulant Balla). Ky aktivitet nuk është aspak politik, por është në kuadër të mbarëvajtjes dhe kontrollit të fillimit të punimeve në këtë objekt, si pjesë e përditshme e procesit të punës së kryetarit të bashkisë."

Referuar pikës 1, të nenit 92, të Kodit Zgjedhor "Institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik, që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve", bashkitë Patos, Dibër dhe Roskovec kanë raportuar veprimtaritë publike pranë ndërfaqes së raportimeve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve duke përmbushur detyrimin e përcaktuar nga neni 92, e Kodit Zgjedhor.

Për aq sa janë raportuar pranë ndërfaqes, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vlerësuar se veprimtaria publike e regjistruara me nr. 323, për bashkinë Roskovec është konsideruar si veprimtari e lejuara që përmbush kërkesat e nenit 91 dhe 92, të Kodit Zgjedhor.

Denoncuesi pretendon se në ky aktivitete ka pasur pjesëmarrje të deputetëve. Referuar Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 8550, datë 18.11.199, "Statusi i Deputetit", deputeti gëzon një status të veçantë në marrëdhëniet juridike që ka me gjithë organet qendrore dhe vendore në vend. **Pjesëmarrja e tij në aktivitetet e organizuara nga kryetari i bashkisë nuk e kthen aktivitetin domosdoshmërisht në një takim elektorale.** Si pjesë e detyrave funksionale të tij, deputeti ka të drejtë të kërkojë shpjegime për çdo çështje që ka të bëjë me përmbushjen e detyrave të kryetarit të bashkisë.

Për aq kohë sa në këtë takim nuk ka fjalime me përmbajtje elektorale, logo, materiale propagandistike dhe çdo element tjetër, që mbart mesazhe elektorale, pjesëmarrja e deputetëve në këto aktivitete nuk është e ndaluar.

Pas verifikimit të kryer, u vlerësua se postimet, në rrjetin social “facebook” të kryetarit të bashkisë, nuk mund të përbëjnë prova të mjaftueshme për të provuar lidhjen midis postimit dhe përdorimit të fondeve publike.

Kryetari i bashkisë është figurë politike dhe mund të postojë në faqen personale mesazhe politike, promovim të nismave politike, festim të arritjeve politike apo çdo lloj materiali tjetër politik, për tërheqjen e elektoratit. Marrëdhëniet personale apo postimet në llogaritë personale në rrjetin social “facebook” të kryetarit të bashkisë, dalin jashtë fushës së zbatimit dhe objekti të rregullimit të Kodit Zgjedhor dhe akteve normative në fuqi dhe si të tilla nuk mund të trajtohen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Parashikimi i ndalimeve për sa i përket këtyre postimeve me natyrë politike interferon në liritë themelore sic janë liria për tu shprehur si dhe liritë dhe të drejtat politike. Kryetarët e bashkive nuk zhvishen nga e drejta e tyre private për të shprehur lirshëm bindjet politike, kjo sidomos në rrjetet e tyre sociale.

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezulton se objekti për denoncimin e regjistruara me **nr. 323 për bashkinë Roskovec**, rase hetimi pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nuk përbën shkelje të neneve 91 dhe 92, të Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “dh”, “f”, “n”, pika 2, 91 dhe 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, , vendimit nr.9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Pushimin e procedimit administrativ ndaj:
 - Zj. Rajmonda Balilaj, kryetar në bashkië Patos;
 - Z. Rahim Spahiu, kryetar në bashkinë Dibër;
 - Zj. Majlinda Bufi, kryetar në bashkinë Roskovec.
2. Moskonstatimin e shkeljes administrative.
3. Rezultatet e këtij vendimi ju njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI